



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ  
Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT  
**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datë 29.09.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional – MPN, në bashkëpunim me bashkëpunëtorin e jashtëm, përfaqësuesin e Shoqatës Maqedonase për Juristë të Rinj, realizoi vizitë të paparalajmëruar në Stacionin Policor Kërçovë. Paraprakisht, Stacioni Policor Kërçovë (SP Kërçovë) u vizitua nga Ekipi i MPN më datë 23.05.2013.

Vizita u realizua në kuadër të mandatit të Avokatit të Popullit – Mekanizmit Parandalues Nacional, që buron nga Protokolli Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese dhe nga Ligji për Avokatin e Popullit. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet realizimi i rregullt i vizitave në vendet ku mund të kryet privimi nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Stacioni Policor Kërçovë është vendosur në ndërtesë me ndërtim të fortë dhe gjendet në qendër të qytetit të Kërçovës. Në hyrje të Stacionit policor Kërçovë nuk ka rampë për personat me ndonjë aftësi të kufizuar, me çka këtyre personave u vështirësohet dhe praktikisht u pamundësohet qasja në brendinë e SP Kërçovë, gjithashtu edhe në hapësirat kujdestare dhe zyrat zyrtare.

Në momentin e vizitës në SP Kërçovë nuk kishte persona të ndaluar me të cilët Ekipi i MPN-së do të mund të bisedonte në lidhje me trajtimin e tyre nga ana e nëpunësve policorë, realizimin e të drejtave të tyre, si dhe për kushtet e ndalimit në këtë Stacion Policor, përkatësisht në momentin e fillimit të vizitës personi u la i lirë.

Në përputhje me Aktvendimin për përcaktimin e stacioneve policore për ndalimin e personave, ky Stacion Policor është caktuar si stacion policor në të cilin mund të zbatohet ndalimi, megjithatë, i njëjti nuk i përmbush standardet minimale vendase dhe ndërkombëtare të parashikuara për ndalimin e personave të privuar nga liria. SP Kërçovë disponon me dy hapësira për ndalimin e personave dhe të njëjtat gjenden në pjesën e bodrumit të Stacionit Policor. Dy hapësirat janë për ndalim individual dhe në secilën prej tyre ka nga një krevat.

Nga matja e kryer në hapësirat e ndalimit, Ekipi i MPN-së konstatoi se edhe pse të dyja hapësirat, sa u përket hapësirave, i përmbushin standardet e parashikuara minimale ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me sipërfaqen e hapësirave, megjithatë, të njëjtat janë në kushte jashtëzakonisht të keqe materiale. Sa i përket sasisë së madhe të lagështisë, MPN-ja në këto hapësira mati mbi 60% R.H. e që është përqindje jashtëzakonisht e lartë e lagështisë në hapësirat në të cilat ndalohen personat.

Në hapësirën për ndalim nuk ka ndriçim artificial, ndërsa kapaku prej metali me vrima të vogla, i vendosur në dritare në hapësirën për ndalim, jo vetëm që nuk mundëson qarkullim të mjaftueshëm të dritës natyrore por, në masë të madhe e pengon edhe ventilimin, përkatësisht hyrjen e ajrit të pastër në hapësirë. Duke filluar nga korridori, i cili çon në hapësirat e bodrumit për ndalim, në shkallët për zbritje deri te hapësirat, në korridor para dyerve të hyrjes në hapësirat dhe në vet hapësirat për ndalim askund nuk ka ndriçim artificial.

Në hapësirat për ndalim, por edhe në gjithë stacionin policor, nuk zbatohet video-mbikëqyrja, përkatësisht funksionon vetëm sistemi për thirrje dhe komunikimi i personit të ndaluar me udhëheqësin e turnit të Stacionit policor.

Gjendja materiale, në të cilën gjenden dy hapësirat për ndalim nuk i përmbushin standardet e parashikuara ndërkombëtare për ndalimin e personave në stacionin policor. Përkatësisht, hapësirat janë të vjetra dhe të amortizuara, me krevate prej hekuri dhe dysheme të papastër prej betoni, pa sistem të ngrohjes dhe me nivel të lartë të lagështisë në mure.

Gjendja e hasur në të dyja hapësirat për ndalimin e personave, seriozisht kontribuon për rritjen e rrezikut nga tortura dhe llojet e tjera të trajtimit jonjerëzor, dhe johuman ndaj personave të ndaluar dhe paraqet shkelje të drejtpërdrejtë të dinjitetit të njeriut.

Nëpunësit policorë dhe përgjegjësi i turnit theksuan se janë të vetëdijshëm për gjendjen e keqe materiale në të cilat gjenden dy hapësirat dhe në mënyrë plotësuese vunë në dukje se gjatë kohës së periudhës së dimrit, kur temperaturat e jashtme janë shumë të ulëta, bëjnë përpjekje t'i reduktojnë në maksimum ndalimet në këtë stacion policor. Megjithatë, nga këqyrja e kryer në evidencën e personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, Ekipi i MPN-së konstatoi se në këto dy hapësira personat ndalohen edhe gjatë periudhës së dimrit dhe në këtë drejtim rekomandon adaptim urgjent të hapësirave dhe furnizim me trupa për ngrohje, deri në rinovimin e tyre komplet, në përputhje me standardet e parashikuara minimale ndërkombëtare, të cilat kanë të bëjnë me hapësirat për ndalimin e personave.

Nga biseda me përgjegjësin e turnit të Stacionit policor, Mekanizmi Parandalues Nacional u informua se personat gjithmonë dhe menjëherë janë njoftuar me shkaqet e privimit nga liria dhe me të drejtat e tyre, në gjuhën të cilën e kuptojnë. Megjithatë, përgjegjësi i turnit, si problem e theksoi faktin se momentalisht Stacioni policor funksionon vetëm me dy përgjegjës të turnit, e që është problem sidomos në periudhat kur njëri nga përgjegjësit e turnit është në pushim mjekësor ose në pushim, kështu që SP Kërçovë, mbetet vetëm me një përgjegjës të turnit, i cili shpeshherë thirret edhe nga shtëpia edhe pas përfundimit të orarit të punës.

Nga biseda e zhvilluar me përgjegjësin e turnit, Ekipi i MPN-së u njoftua se deri në momentin e vizitës nuk kanë pasur rast të ndalimit të personave të mitur në hapësirat për ndalim, por në raste të jashtëzakonshme, kur imponohet nevoja për bisedë të shkurtër, të

miturit vendosen në një të hapësirat zyrtare, me prezencë të vazhdueshme të personit zyrtar dhe me ta bisedohet ekskluzivisht në prezencë të prindit ose punonjësit social.

Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional, gjithashtu, u njoftua se Stacioni policor nuk disponon me buxhet të veçantë për porcionin e ushqimit të personave të arrestuar, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar, konform Procedurave Standarde Operative për trajtimin e personave të ndaluar, në të cilat parashikohet se çdo person i ndaluar më shumë se 6 orë i takon një porcion me ushqim. SP Kërçovë është nën kompetencën e SPB Ohër dhe nga ana e tyre nuk u është dhënë buxhet i veçantë për këtë zë. Sa i përket kësaj çështje, përgjegjësi i turnit na njoftoi se personat zyrtarë e sigurojnë vet porcionin e ushqimit për personat të cilët ndalohen më gjatë se 6 orë.

Mekanizmi Parandalues Nacional zbatoi këqyrje në evidenca dhe në dosjet përkatëse individuale të cilat udhëhiqen në këtë Stacion policor, me qëllim të marrjes së më shumë informacioneve dhe të dhënave për aktivitetet e ndërmarra dhe në përgjithësi për veprimin e nëpunësve policorë me personat e arrestuar, personat e privuar nga liria dhe personat e ndaluar.

Gjatë kontrollit të lidhjes numerike të ngjarjeve të evidentuara në këtë libër me regjistrat e tjerë, mund të vërehet harmonizimi dhe rrjedha kronologjike e ngjarjeve. Qasja e këtyllë ndaj evidentimit të ngjarjeve ditore çon deri në konstatimin se evidenca e ngjarjeve të ditës udhëhiqet në mënyrë të rregullt dhe në kohë.

Në përgjithësi, nga këqyrja e dokumentacionit të plotë, Ekipi i Mekanizmit Parandalues Nacional konstatoi se, evidenca kryesisht mbahet saktë, qartë dhe me rregull. Në librat për evidencë, të cilat udhëhiqen për tre vitet e fundit, nuk shfrytëzohet fare llaku korrektues dhe vërehet rrjedha kronologjike e ngjarjeve të evidentuara.

Gjithashtu, edhe nga këqyrja e disa dosjeve individuale të personave, të evidentuar mbi çfarëdo qoftë baze në Stacionin policor, Ekipi i MPN-së konstatoi se dokumentacioni mbahet me rregull dhe me kujdes dhe në kohë përpilohen dokumentet për çdo ngjarje, gjatë kohëzgjatjes së qëndrimit të personit në Stacionin policor.

Si rezultat i vizitës së realizuar për rikontroll, Mekanizmi Parandalues Nacional përpiloi raport në të cilin i konstatoi gjendjet dhe dha rekomandime përkatëse të cilat ia dërgoi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Stacionit policor, me qëllim që të eliminohen mangësitë dhe rreziqet.